



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

Nr. 5, datë 16.01.2020

**PËR
PËR SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË PARAQITUR NGA
SHOQËRIA "TV KABLLOR VLORA CABLE" SH.P.K., KUNDËR VENDIMIT
NR.21 DATË 17.12.2019 VENDOSUR NDAJ SUBJEKTIT OSHMA "TV ME
KABËLL VLORA CABLE".**

Autoriteti i Mediave Audiovizive

I përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar

Mori në shqyrtim çështjen me:

Ankues: Shoqëria "Tv Kabllor Vlora Cable" sh.p.k..
Objekt: Kundërshtim i vendimit për dënimin me gjobë të vendosur ndaj subjektit OSHMA "Tv me kabëll Vlora Cable", me nr. 22, datë 17.12.2019.
Baza Ligjore: Ligji nr. 97/2013 Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimi nr. 101 datë 07.06.2017 të AMA-s "Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv. Kodi i procedruave administrative i Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 10 279, datë 20.05.2019 "Për kundravajtjen Administrative".

Në datën 05.12.2019, grupi i inspektimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, sipas urdhrit të Kryetarit të AMA-s, nr. 316, datë 02.12.2019 "Për inspektimin e veprimtarisë së subjekteve (OSHMA), inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura për ushtrimin e veprimtarive të palicencuara/paautorizuara", u paraqit në adresën ku janë të

instaluarë pajisjet audiovizive transmetuese të shoqërisë “Vlora Cable” sh.p.k., autorizuar për subjektin OSHMA “Tv me kabëll Vlora Cable”.

Në bazë të rregullores “Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediatic audio dhe ose/audioviziv”, inspektimi u krye në prezencë të përfaqësuesit të subjektit z. Besnik Balleshi dhe programet (kanalet) që ishin në transmetim gjatë kontrollit u mbajtën në procesverbalin e konstatimit të programeve në transmetim dhe, më konkretisht, programet (kanalet) si më poshtë:

- | | | |
|-------------------|---------------------|----------------------|
| 1. Top Channel | 36. A2 Cnn | 68. Fox Life |
| 2. Klan Hd | 37. Rtv 21 | 69. Rai 2 |
| 3. Vizion + | 38. Mediaset Italia | 70. Italia 1 |
| 4. News 24 | 39. Zdf | 71. Rete 4 |
| 5. Rtv Ora | 40. In Tv | 72. Alpha (Greke) |
| 6. Fax News | 41. Tring 7 News | 73. Skai (Greke) |
| 7. Tring Tring | 42. Çufo | 74. Deutsche Welle |
| 8. Tip Tv | 43. Tring Kids | 75. Bloomberg Tv |
| 9. Tring Action | 44. Jolly Hd | 76. Euronews |
| 10. Tring Shqip | 45. Tdc | 77. Rtl |
| 11. Smile | 46. Film Aksion | 78. Cnn |
| 12. Tring 3+ | 47. Tring Super | 79. Tve |
| 13. Rtsh 1 Hd | 48. Tring Life | 80. Tbn (Rusia) |
| 14. Folk + | 49. Film 1 Hd | 81. Tv 5 Monde |
| 15. Elrodi Tv | 50. Film Hits | 82. Fashion One |
| 16. Bbf | 51. Family Hd | 83. Tv 3 Sat |
| 17. Eden 3 | 52. Film Komedi | 84. Kika Tv |
| 18. One Tv Vlora | 53. Tring Comedy | 85. Mtv |
| 19. 6+1 Vlora | 54. Tring Fantasy | 86. Rtk |
| 20. Apollon Tv | 55. Stinët | 87. Nickleodeon |
| 21. Stv Folk | 56. T – Hd | 88. Zdf Neo |
| 22. Tring History | 57. Tring World | 89. Rtsh Film |
| 23. Tring Planet | 58. Explorer | 90. Rtsh Shqip |
| 24. Rai 1 | Shkencë | 91. Rtsh Muzikë |
| 25. Canale 5 | 59. National | 92. Rtsh Fëmijë |
| 26. Ant 1 | Geographic | 93. Rtsh Gjirokastra |
| 27. Living Hd | 60. Tring | 94. Rtsh Korça |
| 28. Abc News | Internacional | 95. Rtsh Sport |
| 29. Top News | 61. Melody Tv | 96. Eurosport 1 |
| 30. Report Tv | 62. My Music | 97. Tring Sport |
| 31. Klan Kosova | 63. Click Tv | News |
| 32. Klan Plus | 64. Balkanika | 98. Tring Sport 1 |
| 33. Ora News | 65. Club Tv | 99. Tring Sport 2 |
| 34. Muse | 66. Fox | 100. Tring Sport 3 |
| 35. Syri Tv | 67. Fox Crime | 101. Supersport 1 |

Me shkresën nr. 4354 prot., datë 6.12.2019 ndaj subjektit të inspektuar është dërguar hetim administrativ dhe është kërkuar të paraqiten pretendime në lidhje me konstatimet e kryera si dhe të depozitohet dokumentacionin për të drejtat e transmetimit për programet (kanalet) që ishin në transemtim gjatë kontrollit për të cilat subjekti nuk disponon asnjë kontratë/marrëveshje. Subjekti me shkresën nr. 4354/2 prot., datë 12.12.2019 ka depozituar pranë AMA-s dokumentacion përkatës për të drejtat e transmetimit me shoqëritë "Digitalb" sh.a, "Tv Klan" sh.a, "Tring Tv" sh.a, dhe me televizionet lokale "One Tv Vlora", "Tv 6+1 Vlora", "Apollon Tv" dhe "Eden 3 Tv".

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar me shkresën e sipërcituar konstatohet se subjekti vijon të mos disponojë asnjë kontratë/marrëveshje për të drejtën e transmetimit të programeve (kanaleve) si më poshtë:

- | | | |
|------------------------|-------------------|----------------------|
| 1. Rai 1 | 13. Italia 1 | 26. Kika Tv |
| 2. Canale 5 | 14. Rete 4 | 27. Mtv |
| 3. Ant 1 | 15. Alpha (Greke) | 28. Rtk |
| 4. Rtv 21 | 16. Saki (Greke) | 29. Zdf Neo |
| 5. Mediaset Italia | 17. Bloomberg | 30. Rtsh Film |
| 6. Zdf | 18. Euronews | 31. Rtsh Shqip |
| 7. National Geographic | 19. Rtl | 32. Rtsh Muzikë |
| 8. Balkanika | 20. Cnn | 33. Rtsh Fëmijë |
| 9. Fox | 21. Tve | 34. Rtsh Gjirokastra |
| 10. Fox Crime | 22. Tbn (Rusia) | 35. Rtsh Korça |
| 11. Fox Life | 23. Tv 5 Monde | 36. Rtsh Sport |
| 12. Rai 2 | 24. Fashion One | 37. Eurosport 1 |
| | 25. Tv 3 Sat | |

Sa më lart, konkludohet se shoqëria "Vlora Cable" Sh.p.k., autorizuar për subjektin OSHMA "Tv me kabëll Vlora Cable", në çastin e ushtrimit të kontrollit, është konstatuar duke përsëritur programe (kanale) të të tretëve, për të cilat nuk ka nënshkruar kontrata/marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të këtyre programeve, fakt ky që vjen në kundërshtim me nenin 32/6, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit: ***"OSHMA-të duhet të transmetojnë programet, përfshirë veprat kinematografike, në përputhje me kushtet dhe afatet për të cilat kanë nënshkruar marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të këtyre veprave."***

Neni 133, pika 7 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton se: ***Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga i licencuari ose i autorizuari, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë: Me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë kur nuk respekton detyrimet e parashikuara në nenin 32 pika 6 të këtij ligji.***

Në respektim edhe të kërkesave ligjore të nenit 132, pika 1, paragrafi i fundit të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar", grupi i inspektorëve mban parasysh edhe faktin se shoqëria "Vlora Cable" sh.p.k., autorizuar për subjektin OSHMA "Tv me kabëll Vlora Cable" në kundërvajtjen e kryer është përsëritës, duke qenë se është ndëshkuar nga AMA edhe më parë për mosrespektim të të drejtave të

transmetimit. Pavarësisht masave dhe parlajmërimit të dhënë nga AMA subjekti vijon me transmetimin e programeve (kanaleve) në kundërshtim me parashikimet ligjore.

Në këto kushte, ndaj subjektit në fjalë është proceduar me Vendimin nr. 21 datë 17.12.2019, duke e dënuar me gjobë atë në masën 1.000.000 (një milion) lekë.

Kundër vendimit nr.21 datë 17.12.2019, me shkresën nr. 4428/1 prot. datë 23.12.2019, subjekti ka paraqitur ankim administrativ, ndër të tjera duke pretenduar se:

1. Në lidhje me kontrollin e ushtruar më datë 05.12.2019, më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj se ky kontroll është kryer në shkelje të rëndë të procedurës së legjislacionit të inspektimit, në prezencë të një punonjësi të kompanisë, është ushtruar në ambientet e zyrës së shitjeve të shoqërisë dhe jo në studion e transmetimit. Ne nuk kemi asnjë kontestim dhe asnjë pretendim në lidhje me profesionalizmin e grupit të inspektimit pro në rastin konkret ka ndodhur një keqkuptim dhe një ngatërresë, kontrolli ushtruar në zyrën e shitjes në Kulla e 1 Rrethi skelë kati 1 Vlorë e kontrolli nuk është kryer në studion ku janë të instaluar pajisjet transmetuese të shoqërisë tonë e cila, është në adresë e lagje tjetër në të cilën edhe nga ana juaj janë ushtruar kontrolle për të parë plotësimin e kushteve për dixhitalizimin.
2. Më lejoni tju sjell në vëmendjen tuaj se kontrolli në fjalë është kryer në një aparat TV ku të gjitha kanalet e lira kombëtare të Rtsh dhe kanale dixhitale tokësore free etj., abonetët i marrim me dekoder DVBT2 ku të gjithë abonentët janë pajisur me këtë dekoder.
3. Grupi i inspektimit nuk ka vënë në dijeni përfaqësuesin ligjor (administratorin) të palës paditëse për organizmin e kushteve të kontrollit si dhe nuk a marrë asnjë kontakt me këtë autoritet për ushtrimin e kontrollit.

Pas njohjes me pretendimet e palës ankuese, në lidhje me pretendimin e parë konstatohet se është i pa mbështetur në parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi për mediat audiovizive për shkak se, në rregulloren “Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv”, miratuar me Vendimin Nr. 101 datë 07.06.2017 të Autoritetit të Mediave Audiovizive, neni 10 pika 1/i përcaktohet:

Vendi i inspektimit, pavarësisht adresës së përcaktuar në urdhrin e inspektimit, mund të jetë: kudo ku ushtron veprimtarinë e tij audio dhe/ose audiovizive subjekti që inspektohet dhe ku ndodhen faktet dhe rrethanat, që lidhen me respektimin, ose mosrespektimin e kërkesave ligjore

Në lidhje me pretendimin e dytë, edhe sikur të merret e mirëqenë se kanalet (programet) e paketës së RTSH-së janë free për shkak të llojit të dekoderit, në këtë rast DVBT2, konstatohet se në transmetim në momentin e kontrollit gjendeshin kanale (programe) në transmetim të cilat nuk janë free në dekoderat DVBT2.

Në lidhje me pretendimin e tretë, në rregulloren “Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv”, miratuar me Vendimin Nr. 101 datë 07.06.2017 të Autoritetit të Mediave Audiovizive, neni 9 pika 1 përcaktohet: ***Fillimi i inspektimit i njoftohet subjektit të inspektimit paraprakisht, ose***

njëkohësisht me fillimin e veprimeve të inspektimit, nëpërmjet dorëzimit të urdhrit të inspektimit, përfaqësuesit të subjektit të inspektimit.

Sa më lart cituar, inspektimi mund të kryhet edhe me një përfaqësues të subjektit prezent në ambientin ku ushtrohet kontrolli si dhe njoftimi kryhet njëkohësisht me fillimin e veprimeve të inspektimit me dorëzimin e urdhrit të inspektimit.

Nga gjithë sa më sipër, konkludohet se, pretendimet e paraqitura në lidhje me rishikimin e gjobës nga shoqëria “shoqëria “Tv Kabllor Vlora Cable” sh.p.k, autorizuar për subjektin OSHMA “Tv me kabëll Vlora Cable” janë të pambështetura në prova e ligj dhe nuk mund të justifikojnë mosrespektimin e parashikimeve ligjore.

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16, nenit 133, pika 11 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”, Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe rregullores “Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatic audio dhe/ose audioviziv”, miratuar me Vendimin nr. 101 datë 07.06.2017 të AMA-s, Autoriteti i Mediave Audiovizive.

VENDOSI:

1. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 21 datë 17.12.2019 për dënimin me gjobë, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, të shoqërisë “Tv Kabllor Vlora Cable” sh.p.k., për subjektin OSHMA “Tv me kabëll Vlora Cable”.
2. Subjekti të ndërpresë menjëherë transmetimin e programeve (kanleve) pa të drejta transmetimi.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, duke filluar nga dita e marrjes dijeni.
4. Ky vendim përbën titull ekzekutiv.
5. Ngarkohet administrata e AMA-s për veprime të mëtejshme sipas ligjit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar: Gentian

Zëvendëskryetar: Sami

Anëtarë: Gledis

Suela

Agron

SALA

NEZAJ

GJIPALI

MUSTA

GJEKMARKAJ

(Kundër)